



KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot me date 24.04.2004 (dymije e kater), para meje noterit u paraqiten personalisht :

SHITESIT:

1. Ioanni Taci, i biri i Jorgos dhe Panajotes, lindur dhe banues ne Janine me 1971, madhor dhe me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar me pasaporte greke me nr. N 78015/1988 leshuar nga Rajoni i Polcise se Janines.

2. Panajoti Likojeorgo i biri i Thodhoriut dhe Jorgjise, datl.1948, lindur ne Mataraga-Mesolojiu-Etoloakarnanias dhe banues ne Janine, madhor dhe me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar me pasaporte greke me nr. KS 675520 leshuar nga Rajoni i Polcise se Janines.

BLERESI:

Arben Paja, i biri i Avniut, lindur me 15.03.1971 ne Tepelene dhe banues ne Tirane me adrese: Rruga "Shyqyri Ishmi", Pallati 43, madhor dhe me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar me pasaporte per jashte shtetit nr. 0439292.

Shitesit Ioanni Taci dhe Panajoti Likojeorgo jane zoterues te 40 % te kuotave me vlere nominale 40.000 leke ne shoqerine "**TEKNOLOGJIA BASHKEKOHORE KLIMATEKNIKA**" sh.p.k.

Me vendimin nr. 1 te dates 20.04.2004 te Asambles se Ortakeve te shoqerise eshte vendosur shitja prej 40% e kuotave te Ioanni Taci dhe Panajoti Likojeorgo me vlere 40.000 leke dhe kalimi i ketyre kuotave ortakut tjetër z. Arben Paja i cili behet ortak i vetem i shoqerise "**TEKNOLOGJIA BASHKEKOHORE KLIMATEKNIKA**" sh.p.k. dhe mbart te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe ka kjo shoqeri.

Nga ana e tij bleresi Arben Paja deklaroi se eshte dakort qe te bleje kuotat nga shitesit dhe deklaroi se u ka paguar atyre vleren nominale 40.000 leke. Shitesit deklaruan se e kane marre kete shume.

Kontrata e shitblerjes u redaktua konform nenit 705 e vijues te Kodit Civil si dhe konform nenit 47. Te Ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregëtare", si dhe konform vullnetit te lire dhe te plote te paleve, te cilet pasi lexuan permbajtjen e aktit, e nenshkruan si me poshte. Une noteri verifikova identitetin e paleve, u lexua me ze te larte akti noterial dhe pasi e gjeta konform vullnetit te tyre e vertetoj si me poshte.


IOANNI TACI

PANAJOTI LIKOJEORGO

ARBEN PAJA

NOTERIA TIRANE
RRETHI I TIRANES
MΟΥΖΑΛΑΙΟΦΙΛΗΤΗΝΩΝ
ΤΗΛ. 66242 - 093 300699
ΑΦΜ 73098023 Β' ΔΟΥ Ιωαννίνων

ΠΑΝΑΓΙΩΤΗΣ Β. ΛΥΚΟΓΕΩΡΓΟΣ
Διπλ. Μηχ/γος Ηλ/γος Μηχ/κός
Ελένης Ζωγράφου 19 - Γιάννινα
τηλ. 49225 - 49226 - FAX 75310



NOTERI

AFRODITI GJEBER